

VENDIM
Nr.208, datë 24.3.2010

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË KOSOVËS, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PROPOZUARA PËR KOMUNËN
GRAÇANICË, KOSOVË**

(Ndryshuar me VKM nr. 992, datë 15.12.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qeverisë së Kosovës t’i jepet një ndihmë financiare, në shumën 400 000 (katërqind mijë) euro, për t’u përdorur për realizimin e disa projekteve në komunën Graçanicë, Kosovë.

2. *Kundërvlehtë në lekë për 200 000 (dyqind mijë) euro t’i shtohet buxhetit të miratuar për vitin 2010, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për t’u përdorur në formën e transfertës.*

2/1. Fondet e pashpenzuara prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, për vitin 2010, të përdoren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rimbursimin e TVSH-së për kontratat e financuara nga IPA-ja, 2008.

3. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për të ndjekur realizimin e projekteve, në përputhje me një marrëveshje, që do të lidhet ndërmjet palës përfituese dhe asaj zbatuese.

4. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratuar për vitin 2010.

5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha